



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2001/ 5 prot

Datë 10.09.2025

V E N D I M
Nr. 1209/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.09.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Anadea” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-47614-05-12-2025, me objekt *Loti 1 “Blerje materiale ndertimi”* me fond limit: 9,585,524 (nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH ose 97,265 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 12/05/2025 është 98.55 Lekë/ Euro, zhvilluar më datë 18.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Devoll
Adresë: Lagjia Nr. 1 Rruga “24 Tetori” Nr. 9, Bilisht Devoll.

Ankimues: Operatori ekonomik “Anadea” SHPK me NIPT L87201401H, me adresë: Lagjia “Qendër, Njësia Administrative Shupenzë, Bulqizë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.05.2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-47614-05-12-2025, me objekt *Loti I “Blerje materiale ndertimi”* me fond limit: 9,585,524 (nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH ose 97,265 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 12/05/2025 është 98.55 Lekë/ Euro, zhvilluar më datë 18.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.

II.2. Në datën 18.06.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 04.07.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Anadea” SHPK	8.240.000	lekë	skualifikuar
2. “Olsi Motors” SHPK	8.325.590	lekë	skualifikuar
3. “Kiço” SHPK	8.329.772	lekë	kualifikuar
4. “Alb Korrekt” SHPK	8.374.310	lekë	kualifikuar
5. “Avduli” SHPK	8.615.530	lekë	kualifikuar
6. “Genti 001” SHPK	8.726.740	lekë	kualifikuar
7. “Avdoli” SHPK	8.728.040	lekë	skualifikuar
8. “Arteo 2018” SHPK	8.977.850	lekë	kualifikuar
9. “Al Dok” SHPK	9.108.660	lekë	kualifikuar
10. “Murati” SHPK	9.385.400	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 04.07.2025 operatori ekonomik “Anadea” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit

- OE Nuk ploteson piken 2.3.1 “Kapacitete teknike” pasi me faturat e ngarkuara nuk verteton se ka kryer furnizime te ngjashme zerat e e kerkuare ne preventivin e AK.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton së më datë 24.07.2025 është Publikuar Njoftim Fituesi Paraparak i procedurës së prokurimit objekt- ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 26.07.2024, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2025/5611 dhe me nr. 2001/2025 prot, datë 28.07.2025, e operatorit ekonomik “Anadea” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-47614-05-12-2025, me objekt Loti 1 “Blerje materiale ndertimi” me fond limit: 9,585,524 (nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH ose 97,265 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 12/05/2025 është 98.55 Lekë/ Euro, zhvilluar më datë 18.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Anadea” SHPK me pretendimet si vijon:

KVO ka gabuar spse OE ka ngarkuar dy fatura te leshuar per AK Ndermarrja Rruga Durres nr. 71/2024 dt 02/12/2024 dhe 21/2025 dt. 04/06/2025 te cilat vertetojne furnizimin me materiale te ngjashme sipas preventivit te AK. Fatura nr. 71/2024 dt. 02/12/2024 materiali i furnizuar eshte beton . Betoni ka ne perberjen e tij cemento, rere dhe granil kurse fatura nr. 21/2025 materialet e furnizuara jane bojra te ndryshme dhe sherbim lysterje. Ne dijenine tone betoni akoma eshte edhe perberes i bordurave te betonit pllakave te trotuareve dhe pllakave te cimentos . KVO ka ngaterruar furnizime te ngjashme me furnizime te njejta mesa duket duke gabuar ne vleresimin e ofertes tone.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2001/1 prot., datë 28.07.2025 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Anadea” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2001/2025 prot, datë 28.07.2025.

II.8. Me shkresën nr. 2587/1 prot, datë 06.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 2001/2 prot datë 11.08.2025 me objekt: “Dërgim Vendimi” autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës nr. 2, datë 05.08.2025 të operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimii të cilit rezulton se ka vendosur mospranimin e ankesës me argumentimin si vijon:

Nga verifikimi i dokuemtacionit te paraqitur nga OE “Anadea” SHPK ne sistemin elektronik te prokurimeve rezulton se per te plotesuar kapacitetin teknik “2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per furnizimet e meparshme te ngjashme, të kryera gjate tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, në nje vlere jo me te vogel se 20 % te vlerës se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet Loti I.

Ka paraqitur si deshmi per te vërtetuar furnizimet e ngjashme faturen Nr. 71/2024 datë 02.12.2024 e cila ka vetem zërin “Beton” dhe faturen Nr. 21/2025 date 04.06.2025 e cila ka zëra: “Boje ambient i jashtem me kova jo me pak se 10 kg”, Bojë ambient i brendshem me kova jo me pak se 10 kg”, “Lysterje ambient i jashtem, Skela per lysterjen e godines (ambient) nga jashtë + rrjeta plasike mbrojtese per ruajtjen paster te ambientit. Siperfaqe totale rreth 600 m /2 shtresa boje) Sipërfaqe totale reth 600m (2 shtresa boje)”, Lysterja ambient i brendshmem siperfaqe nga brenda rreth 1400 m (2 shtresa boje)”.

Nderkohë që AK Bashkia Devoll ne shtojcën 7 te Dokumentave te tenderit “Formulari i sasisë dhe grafikut te levrimit ka kerkuar:

1	Cimento e zakonshme 42.5R	kv	1825
2	Granil nga gur i thyer	m3	961
3	Granil 02 (pluhur guri)	m3	630
5	Gerqele e shuar (qull)	kv	27
6	Hekur betoni I zakoshem 6-10 mm	kg	3000
7	Hekur betoni I zakoshem 12 mm	kg	500
8	Tel bari	kg	28
9	Tel zinku	kg	30
10	Gozhde	kg	205
11	Tulla te lehtesuara kub 20x25x25 cm	cope	1000
12	Blloqe betoni 20x20x40	cope	500
13	Tjegulla vendi	cope	2000
14	Gure kave	m3	600
15	Llamarine xingat e valezuar	m2	300
16	Lende ndertimi druri	m3	14
17	Kripe	kg	40000
18	Lende e trashe pishe e stazh (import cilesia e I)	m3	16
19	Bordura betoni 12x25 cm	m	300
20	Bordura betoni 8x20 cm	m	100
21	Pllaka trotuari granil+boje	m2	600
22	Pllaka cimentoje e zakonshme 20x20, 25x25 cm	m2	100
23	Tuba Ø60 d2	ml	45
24	Tuba Ø50 d2	ml	60
25	Tuba Ø40 d2	ml	60
26	Profil 40x40 d2	ml	60
27	Profil 40x30 d2	ml	60
28	Profil 30x30 d2	ml	60
29	Llamarine e zeze	kg	80
30	Lama 40*5	ml	90
31	Lama 30*5	ml	90
32	Lama 20*5	ml	70
33	Lama 12*3	ml	120
34	Gur Preres	cope	70
35	Elektroda te zakonshme	kg	80
36	Afro	cope	300
37	Silikon	cope	400
38	Doreza alumini per bravat	cope	80
39	Bravo dyer te thjeshta	cope	70
40	Celsa veth	cope	55
41	Fishek brave	cope	50
42	Suva e gatshme thes 25 kg	Thes	400
50	Boje hidromat I bardhe kova 10 litra	litra	65

51	Boje plastiko kova 10 litra	litra	35
52	Astar me baze nefti kova 15 litra	litra	17
53	Rula per lyerje te zakonshem	Cope	18
55	kole	thase	120
54	Stoko patinimi akrelike 25 kg	thase	311

Per sa me siper argumentoj se: Referuar pikes 2.3.1 te DST, AK ka kerkuar si deshmi për permbushjen e eksperiencës së meparshme me objektin e kontratës furnizime të ngjashme me mallrat e sipërpermendur në preventiv nderkohe nga verifikimi i faturave të dorezuara nga OE vertetohet se ky i fundit ka kryer punë dhe jo furnizim me mallra të ngjashme me preventivin.

Pavarsisht se OE pretendon se pjesë e procesit të punës që ai ka paraqitur si dokument provues kanë në përberje disa nga materialet e preventivit, ai ka kryer punë dhe jo furnizime me mallra të ngjashme me preventivin pasi këto materiale OE ankimues i ka siguruar nepermjet blerjes nga të tjerë.

Nga dokumentacioni i dorezuar nga ana e OE verifikohet lehtësisht se ai nuk ka eksperiencën e nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate. Nëse OE ankimues do të kishte furnizime të ngjashme me mallrat objekt prokurimi është OE i pari i interesuar për të paraqitur dokumentacionin provues në sistemin elektronik të prokurimeve.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatoreve ekonomike, të cilët, nepermjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vertetohet se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. AK sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përputhen në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet

të vertetojnë se zoterojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme

nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. AK sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përputhet ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e

percaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit, si dhe qe ka pergatitur ofertën ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Per sa me siper pretendimi i ankimuesit nuk qendron.

Zyrtai i ngarkuar per shqyrtimin e ankeses i ngarkuar nga Titullari i autoritetit kontraktor:

Vendos:

1. Te mos pranoje ankesen e paraqitur nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK per proceduren e prokurimit; Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar-Mallra; Numri i references së procedures: Loti 1: REF-47614-05-12-2025; Objekti i kontrates: Loti 1: Blerje materiale ndertimi; Fond Limit: 9,585,524 (nente milion e peseqind e tetedhete e pese mije e peseqind e njezet e kater) leke pa tvsh e zhvilluar me daten: 18.06.2025 nga Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Devoll.

2. Autoriteti kontraktor, te vere ne dijeni per vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomike te interesuar, brenda dites së nesërme te punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqeruar me shpjegimet dhe dokumentacionin perkates.

3. Vendimi i autoritetit/entit kontraktor u komunikohet te gjitha subjekteve të përfshira në proces.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Anadea” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “OE Nuk plotëson pikën 2.3.1 “Kapacitete teknike” pasi me faturat e ngarkuara nuk vërteton se ka kryer furnizime të ngjashme zërat e kërkuar në preventivin e AK” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.1.1 “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet **Loti I.**

Kur konkurron për 2 (dy) ose 3 (tre) lotet së bashku Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, furnizime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të LOTEVE për të cilat ofertuesi oferton.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.*
- b. *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.*

III.1.2. Në shtojcën 7 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

1	Cimento e zakonshme 42.5 R	kv	1825
2	Granil nga gur i thyer	m3	961
3	Granil 02 (pluhur guri)	m3	630
5	Gerqele e shuar (qull)	kv	27
6	Hekur betoni I zakoshem 6-10 mm	kg	3000
7	Hekur betoni I zakoshem 12 mm	kg	500
8	Tel bari	kg	28
9	Tel zinku	kg	30
10	Gozhde	kg	205
11	Tulla te lehtesuara kub 20x25x25 cm	cope	1000
12	Blloqe betoni 20x20x40	cope	500
13	Tjegulla vendi	cope	2000
14	Gure kave	m3	600
15	Llamarine xingat e valezuar	m2	300
16	Lende ndertimi druri	m3	14
17	Kripe	kg	40000
18	Lende e trashe pishe e stazh (import cilesia e 1)	m3	16

19	Bordura betoni 12x25 cm	m	300
20	Bordura betoni 8x20 cm	m	100
21	Pllaka trotuari granil+boje	m2	600
22	Pllaka cimentoje e zakonshme 20x20, 25x25 cm	m2	100
23	Tuba Ø60 d2	ml	45
24	Tuba Ø50 d2	ml	60
25	Tuba Ø40 d2	ml	60
26	Profil 40x40 d2	ml	60
27	Profil 40x30 d2	ml	60
28	Profil 30x30 d2	ml	60
29	Llamarine e zeze	kg	80
30	Lama 40*5	ml	90
31	Lama 30*5	ml	90
32	Lama 20*5	ml	70
33	Lama 12*3	ml	120
34	Gur Preres	cope	70
35	Elektroda te zakonshme	kg	80
36	Afro	cope	300
37	Silikon	cope	400
38	Doreza alumini per bravat	cope	80
39	Bravo dyer te thjeshta	cope	70
40	Celsa veth	cope	55
41	Fishek brave	cope	50
42	Suva e gatshme thes 25 kg	Thes	400
50	Boje hidromat I bardhe kova 10 litra	litra	65
51	Boje plastiko kova 10 litra	litra	35
52	Astar me baze nefti kova 15 litra	litra	17
53	Rula per lyerje te zakonshem	Cope	18
55	kole	thase	120
54	Stoko patinimi akrelike 25 kg	thase	311

Afatet e lëvrimit: duke filluar nga nenshkrimi i kontrates deri ne dt. 31.12.2025 sipas kerkesave te AK.

III.1.3. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “Anadea” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë tatimore nr. 71/2024, datë 02.12.2024, me vlerë XXXXXXXX lekë pa tvsh.
- Faturë tatimore nr. 21/2025, datë 04.06.2025, me vlerë XXXXXXXX lekë pa tvsh.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficiency dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c)

të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.6. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.7. Në nenin 40 pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore³⁷, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.9. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt - shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin 2.3.1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet **Loti I**.*

Kur konkurron për 2 (dy) ose 3 (tre) lotet së bashku Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, furnizime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të LOTEVE për të cilat ofertuesi oferton.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.*
- d. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.*

KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Anadea” SHPK, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së procedurës së prokurimit objektankimi. Kështu, referuar shtojcës 2 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mallrat objekt prokurimi dhe sasisë respektive të tyre. KPP gjykon se, në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit lidhet me pajisjet didaktike për laboratorin e biologjisë. Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të 37 përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb ratio legis, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit

kontraktor të kërimit të dëshmime për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontraktës, në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontraktës, me një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave. Lidhur me faktin nëse faturat tatimore të dorëzuara nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK plotësojnë apo jo kriterin kualifikues të furnizimeve të ngjashme, KPP do t’i analizojë në 3 (tre) komponentë kumulative dhe konkretisht komponenti i vlefshmërisë, komponenti i ngjashmërisë dhe komponenti i vlerës së realizuar. Për sa i përket vlefshmërisë së faturave të dorëzuara, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, faturat janë të vlefshme për efekt të përmbushjes së kriterit kualifikues të sipërpërmendur dhe të përcaktuar në pikën 2.3.1 të Shtojcës 8/2 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimi pra janë realizuar brenda afatit 3 (tre) vjeçar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës (14.05.2025). Lidhur me komponentin e ngjashmërisë, në analizë të thelluar dhe krahasimore të faturave tatimore të shitjes, të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik “Anadea” SHPK, KPP konstaton, se me anë të faturave tatimore të dorëzuara nuk dëshmon, se ka kryer furnizime të natyrës së shitjes të ngjashme me natyrën e mallrave objekt prokurimi sikurse janë (*Cimento e zakonshme 42.5R; Granil nga gur i thyer; Granil 02 (pluhur guri); Gerqele e shuar (qull); Hekur betoni I zakoshem 6-10 mm; Hekur betoni I zakoshem 12 mm; Tel bari; Tel zinku; Gozhde; Tulla te lehtesuara kub 20x25x25 cm; Blloqe betoni 20x20x40; Tjegulla vendi; Gure kave; Lllamarine xingat e valezuar; Lende ndertimi druri; Kripe; Lende e trashe pishe e stazh (import cilesia e 1); Bordura betoni 12x25 cm; Bordura betoni 8x20 cm; Pllaka trotuari granil+boje; Pllaka cimentoje e zakonshme 20x20, 25x25 cm; Tuba Ø60 d2; Tuba Ø50 d2; Tuba Ø40 d2; Profil 40x40 d2; Profil 40x30 d2; Profil 30x30 d2; Lllamarine e zeze; Lama 40*5; Lama 30*5; Lama 20*5; Lama 12*3; Gur Preres; Elektroda te zakonshme; Afro; Silikon; Doreza alumini per bravat; Bravo dyer te thjeshta; Celsa veth; Fishek brave; Suva e gatshme thes 25 kg; Boje hidromat I bardhe kova 10 litra; Boje plastiko kova 10 litra; Astar me baze nefti kova 15 litra; Rula per lyerje te zakonshem; kole; Stoko patinimi akrelike 25 kg*). KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe

verifikimi i të gjitha elementeve të faturave, rezulton se (faturat) nuk konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, pasi janë të natyrës “Blerje Beton” ose Blerje Bojë dhe lyerje ambjenti), pra operatori ekonomik nuk ka arritur që të dorëzojë dëshmi që ka realizuar furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit. Komisioni gjykon, se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë furnizimi, por si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, por edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës **për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie**. Në rastin konkret, pavarësisht se faturat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimes janë fatura furnizimi me objekte të gjera veprimtarie, në zbatimin e këtyre faturave nuk ka mjaftueshëm zëra të ngjashme në natyrë dhe metodologji me zërat furnizimit objekt-prokurimi. Pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur fatura tatimore në të cilat vërteton se ndër të tjera ka kryer furnizime gjatë tre viteve të fundit konkretisht me artikujt shitje betoni, dhe bojë, por KPP pasi veçoi zërat e mallrave që mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, si më sipër cituar, vëren se, nga përlllogaritja zërat e ngjashëm në faturat e paraqitura nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK, janë në vlerën XXXXXXXX lekë pa TVSH, ndërkohë që në kriterin e kualifikimit kërkohet dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, në një vlerë jo më pak se 20 % të vlerës së fondit të limit, pra në vlerën 1.917.104.8 lekë pa Tvsh.

Sa më sipër KPP vlerëson se, faturat tatimore të shitjes, të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimes “Anadea” SHPK nuk plotësojnë të tre komponentët kumulative në interpretim të kriterit kualifikues. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Anadea” SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme të ngjashme përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik.

III.1.10. Sqarojmë se, bazuar në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, operatori ekonomik “Anadea” SHPK nuk përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në lidhje me eksperiencën e ngjashme, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Në rast se operatori ekonomik “Anadea” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të

mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Anadea” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-47614-05-12-2025, me objekt *Loti 1 “Blerje materiale ndertimi”* me fond limit: 9,585,524 (nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH ose 97,265 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) euro, kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 12/05/2025 është 98.55 Lekë/ Euro, zhvilluar më datë 18.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit..
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Anadea” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

